



Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës L. NR. 03/L – 149 dhe në Rregulloren nr. 02/2011 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, **Universiteti Publik “Kadri Zeka”, Gjilanit**, shpall këtë:

KONKURS

UGJL007 - Zyra për Buxhet dhe Financa

Titulli i vendit të punës: Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore

Numri i referencës: RN00003874

Niveli i pagesës: 500.00; UNI-30

Raporton tek: Drejtor i Zyres per Buxhet dhe Financa

Qëllimi i vendit të punës

1. Sigurimi i zotimeve buxhetore për shpenzimin e buxhetit të planifikuar dhe alokuar, sipas procedurave financiare dhe buxhetore.

Detyrat Kryesore

1. Analizon dhe vlerëson planin rrjedhës të parasë dhe siguron se shpenzimet janë bërë në pajtim me procedurat dhe standardet për buxhet dhe financa;
2. Barazon raportet e shpenzimeve me sistemin e thesarit në bazë tre mujore gjashtë mujor dhe vjetore dhe bashkëpunon me strukturat tjera organizative të ministrisë lidhur me zotimet dhe shpenzimet;
3. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre;
4. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
5. Mbikëqyr dhe zbaton kontrollin efektiv të menaxhimit të parave të gatshme dhe mirëmban dokumentacionin financiar dhe përgatite-inicon dosjet për te gjitha pagesat;
6. Regjistron të gjitha zotimet e shpenzimeve në sistemin e menaxhimit të financave dhe kontrollit sipas llojeve të shpenzimeve dhe i përcjell deri në realizimin e shpenzimeve;
7. Rishikon çdo urdhër zotimi dhe pagese si dhe dokumentet përkatëse për iniciimin e procedurave për prokurim dhe i përcjell për veprim të mëtutjeshme;
8. Siguron që mjetet buxhetore janë në dispozicion për shpenzim dhe janë bërë zotimet përkatëse në sistemet përkatës të institucioneve financiare dhe buxhetore;

Shkathtësitë

Njohuri dhe përvojë në fushën e në fushën e buxhetit dhe financave;
Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit);



Kualifikimi

Diplome universitare, drejtimi ekonomik, financa, biznes apo të ngjashme

Experienca

2 vite përvojë profesionale;

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Pasurisë

Numri i referencës: RN00003875

Niveli i pagesës: 500.000; UNI-30

Raporton tek: Drejtor i Zyres për Buxhet dhe Financa

Qëllimi i vendit të punës

1. Evidentimi, menaxhimi dhe administrimi i pasurisë së ministrisë në përputhje me procedurat ligjore.

Detyrat Kryesore

1. Bashkëpunon me zyrtaret për pranimin e pasurisë dhe me zyrtarët e financave për sigurimin e të dhënave të sakta dhe detajuara për pasurinë
2. Kontrollon dhe mirëmban të gjitha informatat e nevojshme për pasurinë në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi
3. Kryen punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës, dhe pune të cilat mund të kërkohen kohë pas kohe nga mbikqyersi direkt për mbarevajtje të punëve në Zyren e Financave
4. Në çdo fund viti dhe sipas nevojës i regjistron të dhënat mbi pasurinë në regjistrin e pasurisë pasi që pasuritë të jenë klasifikuar dhe të jenë kryer vlerësimet nga ana e komisionet përkatëse
5. Përcjell lëvizjen e pasurisë dhe ofron informacione të duhura lidhur me lëvizjen e pasurisë dhe përgatitë gjithë dokumentacionin për lëvizjen e pasurisë- tjetërsimit
6. Përgatitë dhe ofron të dhëna mbi vlerat e regjistruara të pasurisë për nevoja të raportimit financiar
7. Regjistron dhe administron pasurinë e institucionit në pajtim me procedurat e përcaktuara ligjore
8. Siguron zbatimin e standardeve të kontabilitetit mbi evidentimin dhe zhvlerësimin pasurisë

Shkathtësitë

1. Aftësi në zgjidhjen e problemeve për çështjet teknike ose procedurale që dalin nga procesi i punës
2. Aftësia për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar stafin e nivelit administrativ
3. Njohuri profesionale specifike në menaxhimin dhe administrimin e pasurisë
4. Shkathtësi hulumtuese , analitike dhe të vlerësim të informacionit
5. Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)

Kualifikimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija generalnog sekretara / Office of the Secretary General Njësia e Burimeve Njerëzore / Jedinica za Ljudske Resurse / Human Resources Unit

Diplome universitare, drejtimi ekonomik, financa, biznes, menaxhment,

Eksperienca

2 vite përvojë profesionale

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

ZYRA PER ARKIV, KATI I PARE, ZYRJA NR. 4, UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA", GJILAN

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni me: Kosovare Shabani, në tel: 0280 390 112 ose përmes postës elektronike hrd@uni-gjilan.net prej orës 8:00 -16:00. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetatat ditore dhe në web faqen zyrtare www.uni-gjilan.net, perkatesisht nga data 19.10.2018-02.11.2018.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten: CV-ja, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (diploma universitare), përvojën (vërtetim mbi marëdhënien e punës nga punëdhënësit) si dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune, për të cilin konkurroni.

Kandidatët të cilën hyjnë në përzgjedhje të listës së ngushtë për intervistë do të informohen me telefon, në afat ligjor.

Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.